



ERASMUS edhe në USHT

Të nderuar studentë dhe staf akademik!

Qendra për Shërbime Studentore dhe Karrierë dëshiron t'ju informojë se ERASMUS programi për shkëmbim të studentëve dhe stafit akademik i ka ndarë Universitetit të Shtetëror të Tetovës 15 vende për studentë dhe 3 vende për stafin akademik për vitin akademik 2009 – 2010. Ky program është i projektuar për studentët dhe stafin e fakulteteve të cilët dëshirojnë të vazhdojnë zhvillimin profesional dhe edukativ përmes udhëtimit dhe studimit jashtë vendit. Ju lusim që të gjithë Ju që jeni të interesuar dhe që dëshironi të përfaqësoni Universitetin Shtetëror të Tetovës, jashta vendit, të aplikoni në këtë program të shkëlqyer.

Qendra për Shërbime Studentore dhe Karrierë tashmë pranon aplikacionet tuaja. Ju duhet të caktoni termin me Qendrën para se të dorëzoni aplikacionin tuaj. Megjithatë, kini kujdes ngaqë ka një mori detyrash që duhet të plotësoni para se të caktoni termin. Afati i fundit për aplikim është 13 Maj.

Udhërrëfyeni Juaj për aplikim

Studentët që kanë të drejtë aplikimi: Studentët e vitit të parë nuk kanë të drejtë aplikimi. Vetëm studentët e vitit të dytë dhe më lartë, të cilët kanë të paktën edhe një semestër studime deri-diplomike. Lëndët që do t'i ndjekin duhet patjetër të përshtaten me kërkesat për diplomim të parapara në planprogramin e studimeve në USHT.

Stafi akademik që ka të drejtë aplikimi: Profesorë dhe asistentë që kanë të paktën shkallën Master në fushat e tyre përkatëse.

Universitetet potenciale për studentët dhe stafin akademik janë (ju lutemi kushtoni kujdes gjuhës së ligjërimit në universitetet gjegjëse respektivisht në programin studimor që do të zgjidhni):

1. Universiteti i Shtutgardit i shkencave të zbatuara – Gjermani (<http://www.hft-stuttgart.de/>)
2. Universiteti i Manheim – Gjermani (<http://www.uni-mannheim.de>)
3. Univesiteti i Mariborit – Slloveni (<http://www.uni-mb.si/>)

4. Universiteti i Mursias – Spanjë (<http://www.um.es>)
5. Universiteti i arqitekturës, ndërtimtarisë (inxhinjerisë civile) dhe gjeodezisë – Bullgari (www.uacg.bg)
6. Universiteti i mjekësisë i Grazit – Austri (<http://www.meduni-graz.at>)
7. Universiteti i Stafordshir – Angli (<http://www.staffs.ac.uk>)

Përfitimet dhe obligimet e granteve studentore

1. Grantet jipen për periudhë kohore nga 6 – 12 muaj
2. Pagesat për shkollim janë mbuluara (Nuk ka obligime për pages të shkollimit në universitetin nikoqir)
3. Studentët do të marrin mes 310€ - 400€ në muaj për shpenzime
4. Studentët duhet të paguajnë sigurimin shëndetësor në vendin nikoqir
5. Nëse shuma e ndarë për shpenzime banimi nuk është e mjaftueshme atëherë studentët duhet të mbulojnë pjesën e ngelur të shpenzimeve
6. Studentët duhet të vazhdojnë të paguajnë semestrin në USHT
7. Studentët patjetër duhet të hulumtojnë kërkesat e universitetit ku dëshirojnë të shkojnë para se të caktojnë takim me Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë, pasi që çdo universitet ka rregullat dhe dokumentacionin që kërkon për regjistrim. Ky kërkim është **bazik** dhe i **obligueshëm për secilin aplikant**.

Përfitimet dhe obligimet e stafit akademik

1. Stafit akademik i ofrohen dy lloje të granteve:

a) Lëvizshmëria(mobiliteti) e stafit akademik për ligjërim në universitetin nikoqir:

- i. Anëtari i stafit vendoset në universitetin e caktuar ku do të ligjërojë dhe kontribojë në zhvillimin akademik të studentëve të atij universiteti
- ii. Grantet ndahen për minimum 5 ditë deri në 7 ditë
- iii. Një shumë totale prej 1000€ dhurohet si mbulesë për shpenzimet e udhëtimit dhe banimit

- b) *Lëvizshmëria(mobiliteti) e stafit akademik për trajnim në universitetin nikoqir:*
- i. Anëtarit të stafit i ofrohet mundësia për pjesëmarrje në trajnime, seminare, konferenca, obzervime etj.
 - ii. Grantet ndahen për minimum 5 ditë deri në 7 ditë. Sidoqoftë në varësi të aktivitetit koha e qëndrimit mund të zgjatet
 - iii. Një shumë totale prej 1000€ jipet si mbulesë për shpenzimet e udhëtimit dhe banimit
2. Nëse shuma prej 1000€ nuk është e mjaftueshme atëherë anëtarët e stafit duhet të mbulojnë vet pjesën e ngelur të shpenzimeve.
 3. Anëtarët e stafit duhet të paguajnë sigurimin shëndetësor në vendin mikpritës
 8. Anëtarët e stafit patjetër duhet të hulumtojnë kërkesat e universitetit ku dëshirojnë të shkojnë para se të caktojnë takim në Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë, pasi që çdo universitet ka rregullat dhe dokumentacionin që kërkon për regjistrim. Ky kërkim është **bazik** dhe i **obligueshëm për secilin aplikant**.

Procesi i selektimit

Për shkak të numrit të madh të të interesuarve do të bëhen intervista me studentë dhe stafin akademik me qëllim që të përcaktohen kandidatët më të kualifikuar.

Studentët dhe anëtarët e stafit patjetër duhet të caktojnë takim me Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë para mbajtjes së intervistave dhe t'i komunikojnë Qendrës se në cilin universitetet të BE do të aplikojnë

Selektimi i Studentëve

Studentët potencial do të vlerësohen në bazë të një shkalle me 100 pikë, që përfshin 3 kritere(fusha). 15 studentët më të mirë do të rekomandohen. Sidoqoftë një listë alternative prej 7 kandidatëve do të përgatitet prej studentëve që kanë rezultatet më të mira të ranguar nga numri 16-22. Këta studentë do të përkrahen nga USHT dhe do të aplikojnë për ERASMUS, megjithatë, pjesëmarrja e tyre në këtë program do të varet nga përkushtimi i bërë nga 15 studentët më mirë të ranguar.

Grupi intervistues përbëhet nga Pro-rektori për Arsim, anëtarë nga departamenti i gjuhëve përkatëse, si dhe një profesor nga një fakultet ndryshe nga ai që studenti aplikon. Një vlerësim i detajuar i çdo të intervistuari do të ruhet dhe do të jetë i disponueshëm për auditim të mundshëm nga Kordinatori Nacional i ERASMUS-it.

Kriteret e selektimit u vendosën nga Qendra për Shërbime Studentore dhe Karrierë sipas kërkesave të programit ERASMUS dhe diskutimeve të brendshme të stafit. Kriteret që do të vlerësohen janë : aftësitë gjuhësore – gjuha e huaj 50% (në varësi të universitetit të përzgjedhur), deklarata e qëllimit të studimit 40% dhe nota mesatare 10%.

Detajet e kriterëve sqarohen më poshtë:

1. Aftësitë Gjuhësore – Gjuha e huaj
 - a. Studentët do të vlerësohen në bazë të një shkalle 10 pikëshe mbi baza të njohjes së gjuhës (komunikim dhe shkrim) që shfrytëzohet në universitetin e zgjedhur.
2. Deklarata e qëllimit të studimit
 - a. Studentët duhet t'i përgjigjen dy pyetjeve. Përgjigjet e tyre do të vlerësohen në bazë të një shkalle 10 pikëshe:
 - i. Si do ta përmirësoj edukimin tuaj studimi jashtë vendit?
 - ii. Pse dëshironi të shkoni në universitetin që e keni zgjedhur?
3. Nota mesatare
 - a. Studentët obligohen të dëshmojnë notën mesatare

Konsulentët nga programi ERASMUS kanë rekomanduar të dërgojmë studentë në sa më shumë vende të ndryshme të BE-së, kështu që nëse ka ndarje jo të barabartë ku favorizohet një vend, atëherë Qendra për Shërbime Studentore dhe Karrierë do të përshtat kriteret e selektimit në bazë të kërkesave të programit ERASMUS.

Selektimi i stafit akademik

Kandidatët potencial nga stafi akademik do të vlerësohen në shkallë prej 100 pikëve, në bazë të dy kriterëve të para, gjegjësisht a) njohjes së gjuhës dhe b) deklarata e qëllimit të studimit. Tre kandidatët më të mirë do të rekomandohen. Sidoqoftë një listë alternative prej 3 kandidatëve do të përgatitet nga 4-7 kandidatët tjerë të ranguar sipas rezultatit më të lart të arritur. Anëtarët e stafit njëashtu do të përkrahen nga Universiteti dhe do të aplikojnë për grant nga ERASMUS, sidoqoftë pjesëmarrja e tyre në program varet nga përkushtimi i tyre kundruall detyrimeve që kërkohen në universitetet përkatëse. Në pajtim me udhëzimet e ERASMUS përparësi do ju jepet profesorëve që për herë të parë udhëtojnë jashtë vendit me qëllime profesionale.

Grupi intervistues përbëhet nga Pro-rektori për arsim, anëtarë nga departamenti i gjuhëve, dhe Pro-rektori për shkencë. Një vlerësim i detajuar i çdo të intervistuarit do të ruhet dhe do të jetë i disponueshëm për auditim të mundshëm nga Kordinatori Nacional i ERASMUS-it.

Kriteret e selektimit u caktuan nga Qendra për Shërbime Studentore dhe Karrierë sipas kërkesave të programit ERASMUS dhe diskutimeve të brendshme të stafit. Kriteret që do të vlerësohen: Aftësitë gjuhësore – Gjuha 50%, deklarata e qëllimit të studimit/ligjërimit 50%.

Detajet e vlerësimit sqarohen më poshtë:

1. Aftësitë gjuhësore

- a. Stafit akademik do të vlerësohet në bazë të shkallës prej 50 pikëve, sa ata flasin dhe kuptojnë gjuhën e shfrytëzuar nga universiteti i zgjedhur

2. Deklarata e qëlimit të studimit/ligjërimit

- i. Anëtarët e stafit akademik duhet t'i përgjigjen pyetjeve. Përgjigjet e tyre do të vlerësohen në bazë të shkallës 50 pikëshe:

1. Si do ta përmirësoj zhvillimin tuaj profesional përvoja juaj e fituar jashtë vendit?
2. Me çfarë aftësi specifike prisni të pasuroheni gjatë udhëtimit tuaj profesional?
3. Çka do të përfitojë USHT nga pjesmarrja juaj në programin ERASMUS?

Konsulentët nga programi ERASMUS kanë rekomanduar të dërgojmë anëtarë e stafit në sa më shumë vende të ndryshme të BE-së, kështu që nëse ka ndarje jo të barabartë ku favorizohet një vend atëherë Qendra për Shërbime Studentore dhe Karrierë do të përshtat kriteret e selektimit në bazë të kërkesave të programit ERASMUS.

Të dashur studentë dhe anëtarë të stafit akademik: USHT është krenare që është pjesë e programit ERASMUS dhe shpreson se të gjithë të interesuarit do të aplikojnë dhe të shfrytëzojnë përfitimet e këtij programi të shkëlqyer. **Sidoqoftë ju lutemi të keni parasysh se çdo aplikant PATJETËR duhet të kërkojë dhe zgjedh universitetin para se të caktojë takim me Qendrën.**

Përmbledhja e afateve:

Konkursi për aplikim: **HAPUR**

Afati i fundit për aplikim: **13 maj**

Mezi presim të ndëgjojmë nga Ju.

Me respekt,

Qenda për Shërbime Studentore dhe Karrierë